



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	28.4.2025
Nr.	3457 prot.

NJOFTIM

Për zhvillimin e seancës publike nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datë 29 prill 2025, ora 15:00

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvillon seancë publike si vijon:

Për shqyrtim rishtazi:

1. Për vlerësimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 20 prill – 26 prill 2025.
2. Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 28-29 Prill.
3. Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 130, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, për mosmarrjen dhe mospublikimin e Vendimeve të Kryetarëve të Bashkive për vendet e afishimit të materialeve propagandistike për fushatën zgjedhore.
4. Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 134, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, lidhur me vendimmarrje të paplota të Kryetarëve të Bashkive për vendet e afishimit të materialeve propagandistike për fushatën zgjedhore.
5. Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 135, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, lidhur me mospublikimin e vendimeve të Kryetarëve të bashkive për vendet e afishimit të materialeve propagandistike.
6. Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 139, për vendosjen e një posteri nga kandidati i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në një godinë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

